Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

PËR VITIN 2019

Prishtinë, qershor 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Arvita Zyferi-Hashani, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Ardita Salihu dhe Mehmet Muçaj udhëheqës të ekipit, Enver Ramadani dhe Mimoza Morina-Kelani anëtarë të ekipit, nën menaxhimin e Drejtorit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme....4

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit....5

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore....6

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli....8

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve....24

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja....32

Shtojca II: Letër konfirmimi....35

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për vitin 2019, i cili përfshinë Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Pasqyrat Financiare Vjetore të MMPH-së të prezantuara në Raportin Vjetor Financiar për vitin 2019, që ndërlidhen me pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit dhe shpalosjet për këto pasqyra, janë të plota dhe të sakta.

Sistemi i kontrollit të brendshëm në MMPH nuk është në nivelin e duhur. Edhe pse mangësitë që ndërlidhen me PFV janë jo materiale, mangësitë në Raportin Vjetor Financiar që ndërlidhen me llogaritë e arkëtueshme, detyrimet dhe pasuritë si dhe mangësitë në fushën e pajtueshmërisë që ndërlidhen me të hyrat dhe me pagat e mëditjet janë të mëdha dhe kërkojnë veprime të menjëhershme për të parandaluar dëme të mëtutjeshme të buxhetit të ministrisë.

Edhe pse MMPH ka përgatitur planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve dhe kishte përshkruar veprimet që do të ndërmerren për zbatimin e tyre, implementimi i rekomandimeve nuk është në nivelin e kënaqshëm.

Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm[1]

<u>Opinion i pa modifikuar</u>

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Ministria është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë gjatë procesit të auditimit.

[1] Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1 Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Ministria. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime)dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq deklarimet

mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë, detyrimet dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

MMPH nuk ka vendosur kontrolle të mira në raport me obligimet statutore të saj. Mos zbatimi me konsistencë i rregullave, ka shkaktuar mangësi në procesin e mbledhjes së të hyrave, pagesave, menaxhim jo të mirë të pasurive, obligimeve, e llogarive të arkëtueshme. Këto janë fushat kryesore ku nevojiten veprime konkrete për të parandaluar dëmtim të mëtutjeshëm të buxhetit të ministrisë.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[2]	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**54,885,402**	**60,734,854**	**43,655,369**	**72**	**38,288,425**	**40,267,136**
Granti i Qeverisë - Buxheti	37,857,518	36,627,279	30,142,528	82	34,727,214	39,215,730
Financimi përmes huamarrjes	300,000	300,000	0	0	0	0
Të hyrat nga AKP	7,227,884	13,381,003	13,328,959	100	3,056,483	0
Klauzola e investimeve	9,500,000	9,500,000	0	0		0
Donacionet e jashtme	0	926,572	183,882	20	504,728	1,051,406

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,849,452€. Kjo rritje është rezultat i donacioneve të jashtme në vlerë 926,572€, dhe shumës prej 4,922,880€, rezultat i përshtatjeve buxhetore përmes vendimeve të Qeverisë.

Në vitin 2019, ministria ka shpenzuar 43,655,369€ ose 72% të buxhetit final. Ndër faktorët kryesor që kanë ndikuar në mos realizimin e plotë të buxhetit janë si në vijim: Te Klauzola e Investimeve në

[2] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

vlerë 9,500,000€, janë të përfshira dy marrëveshje në vlerë 7 milion euro që kishin të bëjnë me huamarrjen, dhe të cilat nuk ishin nënshkruar. Ndërsa, për mjetet e ndara prej 2.5 milion euro, edhe pse marrëveshja ishte e ratifikuar, ministria nuk kishte arritur të përgatisë termat e referencës për projektin "Ndërtimi i impiantit për ujëra të zeza në Komunën e Prishtinës". Më tutje, pjesa tjetër e mosrealizimit të buxhetit ndërlidhet me mosrealizimin e projekteve të ndryshme të parapara me buxhetin e vitit 2019.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**54,885,402**	**60,734,854**	**43,655,369**	**72**	**38,288,425**	**40,267,136**
Pagat dhe Mëditjet	2,323,127	2,210,322	2,208,838	100	2,197,516	1,976,772
Mallrat dhe Shërbimet	1,418,081	2,711,107	1,542,613	57	1,555,625	1,419,875
Shërbimet komunale	83,220	83,220	56,490	68	68,363	67,241
Subvencionet dhe Transferet	200,000	200,000	200,000	100	0	0
Investimet Kapitale	50,860,974	55,530,205	39,647,428	71	34,466,921	36,803,248

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte zvogëluar për 112,805€, krahasuar me buxhetin fillestar. Ndryshimi ishte rezultat i zvogëlimit të kësaj kategorie me vendim të qeverisë prej 121,000€ dhe rritjes prej 8,195€ nga donacionet e jashtme.

Buxheti final për mallra dhe shërbime krahas buxhetit fillestar është rritur për 1,293,026€. Kjo rritje ishte për shkak të donacioneve të jashtme në vlerë 918,000€ dhe aprovimit të kërkesës për transfer të mjeteve nga linja buxhetore investime kapitale në mallra dhe shërbime nga Ministri i Financave .

Buxheti final për investimet kapitale ishte rritur për 4,669,231€ në krahasim me buxhetin fillestar, si rezultat i vendimeve të Qeverisë për të kryer pagesat e shpronësimeve.

2.1.1 Të hyrat

MMPH për vitin 2019 kishte realizuar të hyra në vlerë prej 1,075,032€. Të hyrat realizohen nga licencat, shfrytëzimi i ujit, taksa për lejet e ndërtimit, shitja e shërbimeve, lejet mjedisore komunale etj. Këto të hyra MMPH i realizon përmes Departamentit të Ujërave, Departamentit për Mbrojtjen e Mjedisit, Departamentit për Banim dhe Agjencionit Kadastral. Të hyrat e inkasuara derdhen në buxhetin e Kosovës dhe nuk shfrytëzohen nga Ministria. Kemi testuar 15 mostra për teste substanciale në vlerë 352,996€ si dhe 14 mostra në vlerë 189,854€ për teste të pajtueshmërisë.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat vetjake			1,075,032	1,398,646	644,262
Totali			**1,075,032**	**1,398,646**	**644,262**

Çështja A1 – Mos zbatim i marrëveshjes për programimin e shlyerjes së borxhit

Gjetja

Ministri i MMPH-së në vitin 2018, kishte lidhë marrëveshje me kompanitë publike rajonale të ujit me qëllim të programimit dhe shlyerjes së borxheve të akumuluara për shfrytëzimin e ujit gjatë viteve 2007-2017, duke programuar shlyerjen e tyre, në 5 këste, për 5 vite. Shlyerja e borxhit sipas marrëveshjeve fillon nga viti 2018 dhe përfundon në vitin 2022. Neni 5 i marrëveshjeve parasheh se në rast të mos zbatimit të marrëveshjes me MMPH-në për kthimin e borxhit, kompanive publike të ujit, në mënyrë automatike do të ju pushoj vlefshmëria e lejes ujore dhe për pasojë edhe licenca e operimit nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit".

Kemi testuar 5 mostra ku vlera e borxhit për shlyerje sipas marrëveshjeve ishte 216,373€ dhe kemi vërejtur se 3 kompani të ujit nuk kishin shlyer obligimin financiar (këstin) për vitin 2019 sipas marrëveshjes. Vlera e kësteve të pa paguara ishte 128,954€, ministria nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë, siç parashihej me marrëveshje. Kjo kishte ndodhur për shkak të monitorimit të dobët të zbatimit të marrëveshjeve me kompanitë e ujit.

Ndikimi

Monitorimi i dobët i marrëveshjeve për shlyerjen e borxheve ndikon në dëmtim të buxhetit të ministrisë dhe në krijimin e praktikave jo adekuate në të ardhmen për inkasimin e të hyrave të ministrisë.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të siguroj se procedurat për shlyerje të borxheve po zbatohen në përpikëri dhe në rastet e mos respektimit, të marrë masa konkrete ndëshkuese ndaj kompanive ujore, siç parashihet me marrëveshjet për shlyerje të borxhit.

Çështja A2 - Mbikëqyrje e dobët e shfrytëzuesve të ujit

Gjetja

Neni 10 i Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.02/2016 për Strukturën e Pagesave të Ujit parasheh që vendimin financiar për pagesa e nxjerrë autoriteti përgjegjës, i cili e ka lëshuar lejen ujore për shfrytëzimin e ujit, shkarkimin e ujërave dhe shfrytëzimin e inerteve. Përveç tjerash, leja ujore lëshuar nga MMPH për shfrytëzuesit e ujit parasheh që për sasinë e ujit të shfrytëzuar, pala obligohet që çdo tre muaj të informoj me shkrim MMPH-në.

MMPH në vitin 2019 nuk kishte pranuar raporte lidhur me sasinë e ujit të shfrytëzuar nga 37 kompani (4 prej të cilëve janë kompani publike) të cilat kanë leje ujore, dhe në mungesë të raporteve nuk kishte arritur të sigurojë informata lidhur me vlerën financiare të shpenzimit periodik të sasisë së ujit. Rrjedhimisht, MMPH ka dështuar të bëjë faturimin për sasinë e ujit të shfrytëzuar për këto kompani edhe pse ato posedojnë leje ujore dhe e shfrytëzojnë ujin.

Kjo kishte ndodhë për shkak se ministria nuk kishte marrë masa për mungesën e raportimit për sasinë e ujit të shfrytëzuar nga këto kompani.

Ndikimi

Mos faturimi i detyruesve për shkak të mungesës së raporteve për sasinë e ujit të shfrytëzuar, ndikon në dëmtim të buxhetit të ministrisë duke shkaktuar nënvlerësim të të hyrave vetjake dhe të llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të sigurojë monitorimin e procesit të raportimit për shfrytëzimin e ujit nga kompanitë, të sigurojë vlerën financiare të sasisë së ujit të shfrytëzuar dhe të bëjë faturimin në bazë të tarifave të përcaktuara sipas kornizës ligjore.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje për vitin 2019, ishte 2,210,322€, prej tyre ishin shpenzuar 2,208,838€. Numri i lejuar i të punësuarve sipas ligjit të buxhetit ishte 355 punëtor ndërsa në fund të vitit ministria kishte 336 punëtor. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 11 punonjës të rinjë. Kemi testuar 28 mostra për teste substanciale në vlerë 111,843€ dhe 16 mostra për teste të pajtueshmërisë. Përveç kësaj, kemi testuar 38 mostra bazuar në marrëveshjen e Brukselit.

Çështja B1 – Mungesa e evidencave për vijueshmërinë në punë

Gjetja

Ligji 03/L-149 Për Shërbyesit civil të Republikës së Kosovës, neni 36 parasheh që: 'Orari i punës së nëpunësve civilë nuk do të tejkalojë dyzet (40) orë në javë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj' .Po ashtu rregullorja 05/2010 për orarin e punës neni 7 parasheh që: " Gjatë orarit të punës të gjithë nëpunësit civil janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo nëpunës civil shënohet në librin e vijueshmërisë apo në regjistrin elektronik".

Vendimi i Qeverisë nr.06/39 i datës 22.07.2015, aprovon konkluzionet e dakorduara për zbatimin e të ashtuquajturës "Mbrojtja Civile". Në MMPH ishin caktuar të punojnë 38 ish pjesëtar të "Mbrojtjes Civile" të cilët ishin pajisur me akt emërime të cilat ua kanë siguruar vendin e punës.

Ne kemi vërejtur se për 36 zyrtarët e lartcekur, ministria nuk ka dëshmi për ta konfirmuar prezencën e tyre në vendin e punës, apo raporte për punën e kryer gjatë vitit 2019, përderisa ministria kishte bërë pagesën e rregullt të pagave të tyre.

Vlera financiare për shpenzimet e pagave për vitin 2019 për këta 36 zyrtar ishte 163,198€. Kjo gjendje ishte e njëjtë edhe në vitin e kaluar dhe e njëjta ishte raportuar në raportin tonë të auditimit për vitin 2018. Kjo ka ndodhur për shkak se nuk janë zbatuar kontrollet menaxheriale për të siguruar se të gjithë të punësuarit janë të pranishëm në vendin e punës gjatë orarit të punës.

Ndikimi

Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmërinë në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të sigurojë se bëhet monitorimi i rregullt i vijueshmërisë në punë për të gjithë punonjësit e ministrisë dhe në rastet e mos respektimit të orarit të punës të merren masa konkrete siç parashihen me kornizën e aplikueshme ligjore.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe komunali në vitin 2019 ishte 2,794,327€, prej tyre ishin shpenzuar 1,599,103€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me furnizime për zyrë, karburant për vetura, shpenzime për udhëtime jashtë vendit, mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve, shërbime kontraktuese si dhe shpenzime komunale. Në vitin 2019 ishin 162 persona të angazhuar me kontrata për shërbime të veçanta, ku pjesa dërmuese e tyre ishin të angazhuar nga vitet[3] e më hershme. Vlen

[3] Numri i të angazhuarve me kontrata për shërbime të veçanta në 2018 ishte 148 persona.

të theksohet se numri i këtyre të angazhuarve gjatë vitit 2019 është zvogëluar për shkak të mos vazhdimit të kontratave të përfunduara[4].

Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime kemi testuar 22 mostra për teste substanciale në vlerë 111,505€ si dhe 12 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 – Angazhim me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta pa procedura të rekrutimit dhe më gjatë se gjashtë muaj

Gjetja

Sipas Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Neni 12, pika 4 - emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura "Marrëveshje për shërbime të veçanta" (MShV) të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Kemi testuar 6 mostra të cilat ishin emëruar me marrëveshje për shërbime të veçanta dhe kemi identifikuar se në dy raste të cilët ishin të angazhuar si roje pylli në parkun kombëtar, afati kohor i angazhimit ishte më shumë se gjashtë muaj. Po ashtu për këto dy raste ministria nuk kishte zhvilluar ndonjë procedurë të rekrutimit në vitin 2019.

Ndikimi

Angazhimi me marrëveshje për shërbime të veçanta më të gjatë se gjashtë muaj dhe mosrespektimi i procedurave të thjeshtësuara të rekrutimit ka ndikuar në dëmtimin e konkurrencës dhe në mohimin e mundësisë ndaj kandidatëve tjerë potencial për tu kualifikuar në këto pozita.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të siguroj se angazhimet me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta bëhen duke aplikuar procedurat e thjeshtësuara të rekrutimit të parapara me ligj dhe kohëzgjatja e tyre të jetë brenda afatit 6 mujor.

[4] 67 të angazhuarve për projektin 'Ta pastrojmë Kosovën' dhe 21 të angazhuarve tjerë iu ka përfunduar kontrata gjatë vitit 2019 dhe nuk iu ka vazhduar më.

Çështja A3 -Tejkalimi i vlerës së kontratës kornizë

Gjetja

Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/ L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, neni 22, parasheh se "Në rast se kontrata publike kornizë lidhet për më pak se tridhjetë e gjashtë (36) muaj, ajo nuk mund të zgjatet mbi afatin e përcaktuar, pa zhvilluar procedurat e reja të prokurimit. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e kontratës publike kornizë duhet të përcaktohet që në fillim të procesit të prokurimit. Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijim prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%). Nëse urdhër-blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%) pa marrë parasysh datën origjinale të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht".

MMPH me datën 12.07.2016, kishte lidhur kontratën publike kornizë "Furnizim me toner për nevojat e ministrisë. Vlera e kontratës ishte 44,953€. Ne kemi identifikuar se MMPH gjatë periudhës 2016-2019 kishte bërë furnizime në vlerë 64,814€, duke bërë tejkalimin e vlerës së kontratës për 6,375€[5] mbi normën e lejuar 30%.

Kjo ka ardhur si rezultatit i një mbikëqyrje të dobët të ecurisë së realizimit të kontratës nga menaxheri i kontratës.

Ndikimi

Tejkalimi i kontratës mbi normën e lejuar mund të ndikojë që organizata buxhetore të hyjë në obligime financiare të pa planifikuara.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin në vazhdimësi ecurinë e realizimit të kontratave, në mënyrë që të parandalohen tejkalimet e furnizimeve. Në rastet kur tejkalimi i kontratës arrin shkallën 30% kontrata duhet të ndërpritet menjëherë.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere për vitin 2019 ishte 200,000€ i cili është shpenzuar në tërësi nga ministria. Kemi testuar 5 mostra për teste substanciale në vlerë 34,950€ si dhe 3 mostra për teste të pajtueshmërisë.

[5] 44,953€+(44,953€*30%)=58,439€, shpenzimi i ndodhur 64,814€-58,439€ përfshirë 30%=6,375€ tejkalim.

Çështja A4 – Mos dërgimi i planit për subvencionim të OJQ-ve në Qeverinë e Kosovës

Gjetja

Rregullorja Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve - neni 6 'Plani vjetor i mbështetjes financiare' parasheh se ofruesit e mbështetjes financiare përgatisin pjesën e planit vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës dhe i dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

MMPH kishte subvencionuar 33 OJQ gjatë vitit 2019. Ministria nuk kishte dërguar planin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të në zyrën përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit , siç parashihet me rregulloren për subvencionim të OJQ-ve. Kjo kishte ndodhur për shkak se MMPH e kishte neglizhuar këtë proces.

Ndikimi

Mos dërgimi i planit vjetor të mbështetjes financiare ndikon që Zyra e Kryeministrit të mos ketë informacion për shumën e mbështetjes financiare për vitin fiskal, fushat në të cilat do të ofrohet mbështetja financiare për OJQ, objektivat e mbështetjes financiare dhe kohën realizimit të projekteve përfituese.

Rekomandimi A4

Ministri duhet të siguroj që më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës, të përgatisin planin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të dhe t'ia dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 55,530,205€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 39,647,428€. Shpenzimet kanë të bëjnë kryesisht me pagesat për shpronësime të tokave si dhe investime publike infrastrukturore. Kemi testuar 100 mostra për teste substanciale në vlerë 20,872,319€ si dhe 11 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore

Gjetja

Neni 4 pika 2 e Udhëzimit Administrativ nr. 08/2009 për Ekzekutim dhe Pagesën e Vendimeve Përmbaruese të Gjykatave, përcakton se "Departamenti i Thesarit verifikon nëse lënda shkresore është e kompletuar dhe urdhëri ose vendimi përmban të dhëna të plota dhe të sakta për debitorin dhe kreditorin të cilat duhet të paguhen, informatat lidhur me llogarinë e tyre bankare, organizatën buxhetore nga buxheti i secilës duhet të paguhet urdhëri ose vendimi, si dhe shumën e përcaktuar në urdhër ose vendim".

Ne kemi identifikuar se shpenzimet e realizuara përmes vendimeve gjyqësore ishin 583,667€. MMPH paguan vazhdimisht shpronësime përmes vendimeve gjyqësore. Kjo, për shkak se pronarët që kanë qenë pjesë e procesit të shpronësimit, në rastet kur ata janë të pa kënaqur me vendimin përfundimtar të shpronësimit, kanë të drejtë të ankohen në gjykatë. Në disa raste kur pala fiton kontestin, nuk dërgon dokumentacionin e nevojshëm për pagesë në ministri, si kopjen e llogarisë bankare dhe letërnjoftimit, por e dërgon direkt te përmbaruesi. Kjo shkakton shpenzime shtesë për procedura përmbarimore. Nga pagesat e bëra ne kemi testuar gjithsej 5 mostra në vlerë 432,398€, ku në kuadër të kësaj vlere kemi vërejtur se ishin paguar shpenzime përmbarimore në vlerë 9,371€.

Kjo ka ndodhur për shkak të pamundësisë që kishte ministria për t'i siguruar kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për procedim të pagesës.

Ndikimi

Shpenzimet e taksave përmbarimore nuk i shtojnë vlerë arritjes së objektivave dhe rrjedhimisht ndikojnë në dëmtimin e buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të sigurojë që pas pranimit të vendimeve nga Gjykata të siguroj kompletimin e dokumentacionit nga akterët e përfshirë në proces me qëllim që lënda të kompletohet dhe të procesohet për pagesë.

Çështja B4 - Klasifikimi i gabuar i shpenzimeve brenda kategorisë Investime Kapitale

Gjetja

Sipas nenit 18 të Rregullores 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate të përcaktuara me Udhëzimin administrativ për planin kontabël. Plani kontabël parasheh regjistrimin e secilit shpenzim në kodin adekuat brenda kategorisë ekonomike.

Pothuajse të gjitha pagesat për shpronësimet e tokave nuk regjistrohen në kodin adekuat 32100 –Toka, por regjistrohen si ndërtim i auto rrugëve 31210 dhe të tjera. Vlera e keq klasifikimeve brenda kategorisë së investimeve kapitale ishte 3,730,099€. Vlen të theksohet se MMPH pas marrjes së raporti tonë të auditimit, ka filluar që shpenzimet e shpronësimit t'i regjistroj në kodin adekuat.

Kjo kishte ndodhur për shkak të moszbatimit me konsistencë të planit kontabël nga ana e zyrtarëve financiar.

Ndikimi

Edhe pse gabimet në klasifikim të shpenzimeve ishin brenda kategorisë për investime kapitale, regjistrimet e tilla ndikojnë në paraqitje jo të drejtë të shpenzimeve brenda kategorisë ekonomike.

Rekomandimi B4

Ministri duhet të siguroj se për vitet vijuese shpenzimet e shpronësimit të regjistrohen sipas planit kontabël në mënyrë që ato të klasifikohen saktë.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në Raportin Vjetor Financiar (RVF) e pasurive kapitale është 280,966,336€, e pasurive jokapitale është 863,473€ si dhe e stoqeve 69,979€. Kemi testuar 100 mostra për testim substancial në vlerë 21,131,611€. Në aspektin e pajtueshmërisë kemi vlerësuar nëse ministria ka vepruar në pajtim me kërkesat e rregullores për pasuri. Çështjet e dala janë të përshkruara më poshtë.

Çështja A5 – Mos azhurnim i regjistrit të pasurive

Gjetja

Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, neni 13 blerja dhe ndërtimi i pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore përcakton se: të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyllë llogarinë e investimeve në vijim, ndërsa organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj.

Pasuria kapitale me vlerë mbi 1,000€ nuk është prezantuar saktë në RVF. MMPH projektet e financuara për përfituesit tjerë me rastin e pagesës i kishte regjistruar si investime në vijim mirëpo edhe pse kishte përfunduar projekti dhe ishte bërë pranimi teknik ato nuk ishin fshirë nga regjistri i pasurive të ministrisë. Projektet e identifikuara janë: Impianti për riciklimin e mbeturinave në Komunën e Mitrovicës në vlerë 2,321,194€ (pranimi teknik 19.12.2019), Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Breznicë në Komunën e Obiliqit në vlerë 28,199€ (pranimi teknik 20.11.2019), dhe Kanali për ujin dhe parandalimin e rrëshqitjes së tokës në Komunën e Shtërpcës 55,978€ (pranimi teknik 27.11.2019).

Shkaku i mos largimit të këtyre projekteve nga regjistrat e pasurive kapitale sipas ministrisë është se këto projekte janë përfunduar në fund të vitit 2019, prandaj nuk kanë arritur të barten te organizatat përfituese ku edhe e gëzojnë të drejtën e pronësisë.

Ndikimi

Mos azhurnimi i regjistrit të pasurive ndikon në mbivlerësimin e pasurive kapitale jo financiare dhe krijon një çorientim/pa saktësi për palë të ndryshme të interesit apo për shfrytëzues të raportit financiar.

Rekomandimi A5

Ministri duhet të siguroj që regjistri i pasurive të azhurnohet me kohë, me qëllim që vlera e pasurive jo financiare të prezantohet drejtë në RVF dhe të gjitha pasuritë që financohen për organizatat tjera pas plotësimit të kushteve të barten tek përfituesit.

Çështja A6 - Inventarizimi i pasurive jo në pajtim me rregulloren

Gjetja Rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, neni 6 parasheh që "Zyrtari Kryesor Administrativ ka përgjegjësi të themelojë Komisionin për Vlerësim të Pasurisë jo Financiare dhe Komisionin për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare".

Ministria, nuk kishte themeluar komisionet për vlerësimin dhe inventarizimin e pasurive jo financiare dhe si rezultat i kësaj nuk ishte bërë vlerësimi dhe inventarizimi i pasurive për vitin 2019. Kjo kishte ndodhur për shkak të mos përfilljes së procedurave të rregullores nga menaxhmenti i ministrisë.

Ndikimi Mos inventarizimi i pasurive jo financiare, rrit mundësinë e shpërdorimit të tyre. Rrjedhimisht, kjo ndikon që vlera e pasurive të mos raportohet saktë.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të siguroj që çdo fund vit të formohen komisionet e parapara me rregullore për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive në mënyrë që të shmangen devijimet në raportimin e vlerës së pasurive në Raport Vjetor Financiar.

2.3 Llogaritë e arkëtueshme

MMPH në Raportin Vjetor Financiar (RVF) të vitit 2019, ka shpalosur Llogaritë e Arkëtueshme (Ll/A) në vlerë prej 568,624€, që krahasuar me vitin e kaluar (1,416,233€) ato ishin zvogëluar. Arsyeja e zvogëlimit të llogarive të arkëtueshme, ishte sepse ministria në vitin 2019, rastet që ishin në procedurë gjyqësore nëpër gjykata i ka vendosur si pasuri kontingjente në RVF. Llogaritë e arkëtueshme përbëhen nga ngarkesat për shfrytëzimin e ujit (537,865€), dhe nga lejet e ndërtimit (30,759€). Më tutje, në RVF ministria ka prezantuar 2,642,450€ pasuri kontingjente të cilat kanë të bëjnë me pretendimet e ministrisë ndaj palëve tjera që nuk kanë respektuar kërkesat ligjore dhe janë në procedurë gjyqësore. Gjatë auditimit të llogarive të arkëtueshme kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

Çështja A7 – Mungesë e veprimeve ndaj shfrytëzuesve të ujërave pa leje ujore

Gjetja

Ligji nr. 04L-147 Për Ujërat e Kosovës neni 97, parasheh në hollësi veprimet dhe kompetencat që duhet të ndërmarrë Inspektorit i ujërave në rastet kur identifikon kryerje të aktiviteteve pa leje ujore apo në kundërshtim me lejen. Kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e nxjerra në bazë të këtij Ligji, inspektori i ujërave i raporton Ministrisë me shkrim për parregullsitë dhe mungesat dhe me aktvendim do t'i caktojë masat dhe afatet për eliminimin e tyre. Inspektori për ujëra dhe inspektori i autorizuar i ujërave duhet ta informojë policinë kur dyshon se është kryer vepër penale në pasuritë ujore.

Nga regjistri i pranuar prej ministrisë për shfrytëzuesit e ujit kemi vërejtur se, janë mbi 70 detyrues (shfrytëzues të ujit) të cilëve ju ka skaduar leja ujore dhe sipas ministrisë nuk iu ka vazhduar më për shkak të mos shlyerjes së borxheve të akumuluara. Edhe pse, sipas ministrisë këta shfrytëzues vazhdojnë të shfrytëzojnë ujin pa leje ujore dhe pa e kryer obligimin financiar, inspektorati nuk kishte marrë veprime konkrete për ndërprerjen e aktiviteteve të tyre. Kjo situatë ka ndodhur si rezultat i ankesave të vazhdueshme të shfrytëzuesve të ujit të cilët e kanë kundërshtuar pagesën e taksës së përcaktuar sipas UA nr.06/2006 Për strukturën e pagesave të ujit, me arsyetimin se tarifat ishin shumë të larta në krahasim me vendet e rajonit.

Ndikimi

Mungesa e veprimeve të nevojshme për parandalimin dhe rregullimin e dukurive të tilla ndikon në nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe në dëmtimin e buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi A7

Ministri të sigurojë se po bëhet monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të ujërave të Kosovës dhe në rastet e keqpërdorimit nga kompanitë që operojnë në këtë fushë, të marrë masa konkrete për ndalimin e veprimeve të jashtëligjshme sipas dispozitave të parapara me kornizën ligjore në fuqi.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Në RVF ministria kishte prezantuar 265,750,022€, obligime të papaguara të cilat ishin të mbivlerësuara. Detyrimet e pa paguara përbëhen nga shpronësimet e pronave të cilat janë bërë përmes vendimeve të Qeverisë dhe obligime tjera për kategoritë mallra dhe shërbime dhe investime kapitale. Kemi testuar 8 mostra për teste substanciale në vlerë 88,617,849€ si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Sipas të dhënave të ofruara nga ministria, 4,806,327€ janë obligime kontraktuale të cilat priten të realizohen në vitet vijuese.

Çështja A8- Mbivlerësim i obligimeve të papaguara

Gjetja Obligimet e papaguara të raportuara sipas nenit 17 të RVF-së ishin prezantuar në vlerë 265,750,022€, ndërsa do të duhej të prezantoheshin në vlerë 233,514,955€[6], duke shkaktuar një mbivlerësim prej 32,235,067€.

Kjo ka ndodhur për shkak të pakujdesisë së zyrtarit financiar i cili ka prezantuar dy herë kërkesat e shpronësimit në raportin e obligimeve dhe rrjedhimisht këto shënime janë bartur edhe në RVF.

Ndikimi Mbivlerësimi i obligimeve të papaguara ndikon në prezantimin jo të saktë të informatave në RVF-së dhe krijon paqartësi tek përdoruesit e RVF-së.

Rekomandimi A8 Ministri të siguroj se mbahen evidenca adekuate lidhur me obligimet e ministrisë në mënyrë që shënimet në RVF të jenë të sakta.

2.4.2 Pagesat e Shpronësimeve

MMPH është përgjegjëse për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga procesi i shpronësimit. Këto shpenzime bëhen nga buxheti i ndarë për investime kapitale. Buxheti final për shpenzime të shpronësimit për vitin 2019, ishte 20,215,037€, prej të cilave ishin shpenzuar 20,188,139€. Obligimet financiare për shpronësimet e bëra me vendime të qeverisë për periudhën 2010-2019 kanë arritur 231,702,806€[7], prej të cilave 88,915,752€ i takojnë vendimeve të nxjerra në vitin 2019, të cilat ministria duhet t'i paguaj brenda dy viteve nga data e hyrjes së vendimeve në fuqi.

[6] 231,702,806€, duhet të jenë obligime financiare për shpronësime dhe 1,812,149€, obligime për mallra dhe investime kapitale.

[7] Obligimet për shpronësime përbëhen nga: obligimet për shpronësimin e pronave private 119,369,984€, për shpronësimin e pronave komunale 11,130,262€, për shpronësimin e pronave shoqërore 85,347,035€, dhe për shpronësimin e pronave publike 15,855,525€.

Çështja A9 - Mos-pagesa e obligimeve financiare të shpronësimit

Gjetja

Neni 39 i Ligjit nr. 03/l-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë parasheh se "Zyrtari Kryesor Financiar i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Kemi vërejtur se 31,591,176€, ishte vlera e aplikimeve (kërkesave) të pronarëve për kompensim të shpronësimit në vitin 2019, të cilat nuk kanë arritur të procedohen për pagesë. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore të ndara për shpronësime.

Ndikimi

Mos kryerja e me kohë obligimeve financiare për shpronësime, ndikon që ministria të përballët me padi nga ish-pronarët e pronave të shpronësuara, ku për shkak të taksave gjyqësore rritet edhe më shumë obligimi ndaj shpronësimeve.

Rekomandimi A9

Ministri i MMPH-së në bashkëpunim me akterët tjerë të ndërlidhur në këtë proces, të siguroj buxhet të mjaftueshëm për t'i kryer obligimet financiare të shpronësimeve të cilat janë duke u rritur nga viti në vit.

Çështja B5- Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja	Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39, paragrafi 1 parasheh që ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore. Ministria, mbi 236,941€, obligime nuk i kishte paguar brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditëve. Këto obligime kanë të bëjë me mallra dhe shërbime dhe investime kapitale. Kjo ka ndodhur për shkak të mos zbatimit në tërësi të rregullave ligjore për shpenzimin e parasë publike nga zyrtarët përgjegjës për t'i shlyer obligimet brenda afatit të paraparë.
Ndikimi	Mos kryerja e obligimeve sipas afateve të parapara rritë rrezikun që borxhet të rriten si dhe rrit mundësinë e padive gjyqësore ndaj ministrisë. Kjo mund të shkaktoj edhe çrregullime tjera buxhetore gjatë vitit.
Rekomandimi B5	Ministri duhet të siguroj se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor në mënyrë që të shmangen pagesat direkte nga Thesari.

2.4.3 Detyrimet Kontingjente

Detyrimet kontingjente në fund të vitit 2019 janë 31,879,567€ dhe ato ndërlidhën kryesisht me pretendimet e palëve për shpronësimin e tokave.

2.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditorë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. NjAB kishte planifikuar dhe realizuar gjashtë (6) auditime për vitin 2019, dhe një me kërkesë. Janë dhënë gjithsej 30 rekomandime ku 10 ishin në proces, 12 janë zbatuar dhe 8 nuk ishin zbatuar ende.

NjAB kishte përgatitë dhe dorëzuar më kohë raportin vjetor të punës për vitin 2019, në Njësinë Qendrore Harmonizuese.

Komiteti i auditimit kishte mbajtur katër (4) takime deri në përfundimin e fazës së auditimit për vitin 2019, ku ishin shqyrtuar gjetjet dhe rekomandimet e NjAB-së.

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit të MMPH-së për PFV-të e vitit 2018 ka rezultuar me 17 rekomandime. MMPH kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna.

Po ashtu ka dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve (30 shtator dhe 15 mars) sipas kërkesave të dala nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 4 rekomandime janë zbatuar, 2 ishin pjesërisht të zbatuara, 1 është në proces, 7 nuk janë adresuar ende dhe 3 janë të pa zbatuara por të mbyllura. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
A1	PFV	Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarrë masat e nevojshme për eliminimin e shkaqeve që kanë shkaktuar theksimin e çështjes. Në këtë drejtim duhet të ndërmerret identifikimi dhe evidentimi në regjistra, i informatave në lidhje me pasuritë, obligimet dhe llogaritë e arkëtueshme, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.	Gjetja e cila ndërlidhet me regjistrimin e pasurive mbi 1,000€, dhe llogaritë e arkëtueshme është adresuar, ndërsa gjetjet që ndërlidhen me mos regjistrim të pasurive nën 1,000€, regjistrin e lejeve ujore, obligimet dhe pagesat e parregullta mbetet i pa adresuar.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
B1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të siguroj që hartimi i buxhetit është mbështetur mbi një analizë të detajuar të të gjithë faktorëve që ndikojnë në ekzekutimin e tij, për të shmangur diferencat në mes planifikimit dhe shpenzimeve. Ministri, gjithashtu, duhet të sigurohet se janë eliminuar të gjitha barrierat lidhur me ekzekutimin e projekteve, si dhe të inicioje me kohë procedurat e prokurimit.	Edhe pse në planin e veprimit ishte vendosur që rekomandimi do të zbatohet në dhjetor 2019, një gjë e tillë nuk kishte ndodhur për faktin se niveli i realizimit të buxhetit final për 2019 ishte 72%. Pra diferencat në mes planifikimit dhe realizimit të buxhetit ishin domethënëse.	Rekomandim i pa zbatuar i mbyllur
C1	Mungesa e evidencave për vijueshmëri në në punë	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta diskutoj edhe në Qeveri, duke qenë se ky problem është i përhapur edhe në ministritë tjera.	MMPH kishte bërë përpjekje për të adresuar këtë çështje së bashku me komunat dhe MAPL-në, mirëpo për vitin 2019, gjendja është e njëjtë sikurse në vitin 2018.	Rekomandim i pazbatuar

B2	Aplikimi i koeficientev e të ndryshëm për pozita të njëjta	Ministri duhet të siguroj që pagesa e zyrtarëve bëhet sipas përshkrimit të detyrave të punës, duke shmangur mundësinë e pagesave të ndryshme për pozitat e njëjta.	Menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret për të adresuar këtë çështje me arsyetimin se janë duke pritur ligjin e ri të pagave.	Rekomandim i mbyllur i pa zbatuar
B3	Mangësi në angazhimin e punonjësve me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta	Ministri duhet të siguroj që të zbatohen afatet ligjore të kohëzgjatjes së angazhimit me MShV, se kontratat e tilla përdoren vetëm për shërbime të veçanta, dhe jo për pozita të zakonshme, si dhe çdo angazhim bëhet përmes procedurave të kërkuara me ligj.	Menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret për të adresuar këtë çështje.	Rekomandim i pazbatuar
A2	Përkrahje financiare për mbulimin e shpenzimev e të udhëtimit për personat të cilët nuk ishin pjesë e ministrisë	Ministri duhet të siguroj se çdo shpenzim i bërë nga buxheti i ministrisë bëhet për financimin e aktiviteteve të ministrisë, është i dokumentuar dhe është në përputhje me rregulloret financiare.	Ne gjatë vitit 2019 nuk kemi identifikuar ndonjë mangësi të kësaj natyre.	Rekomandim i zbatuar
A3	Vonesa në realizimin e planit të prokurimit për projektet kapitale	Ministri duhet të siguroj se me rastin përgatitjes së planit vjetor të prokurimit, të merren parasysh të gjithë faktorët që mund të ndikojnë në realizimin e planit, si: zgjidhja e kontesteve pronësore, përgatitja e projekteve ekzekutive, inicimi me kohë i procedurave të prokurimit, formimi i komisioneve të vlerësimit me përvojën dhe ekspertizën e duhur, etj.	Ne gjatë vitit 2019 nuk kemi identifikuar ndonjë mangësi të kësaj natyre.	Rekomandim i zbatuar

A4	Planifikim jo i mirë i buxhetit dhe fillimi i projekteve pa sigurimin e parakushtev e për implementi m	Ministri duhet të siguroj se do të aplikohen në mënyrë strikte kërkesat ligjore në mënyrë që planifikimi buxhetor dhe hartimi i projekteve kryesore të bëhet në përputhje me kushtet në terren, në mënyrë që implementimi i projekteve të realizohet në kohë, dhe pa shpenzime shtesë. Gjithashtu, para kontraktimit të punimeve, për secilin projekt të financuar nga MMPH, duhet të sigurohet pajisja me të gjitha lejet e nevojshme.	Menaxhmenti në disa raste kishte nënshkruar kontrata sipas planifikimeve buxhetore ndërsa vetëm në një rast kemi vërejtur se gjendja ishe sikur vitin e kaluar. Kontrata ishte 898,900€ ndërsa buxheti 850,000€. Me qenë se ishte si një rast vetëm nuk e kemi trajtuar në raport.	Rekomandim pjesërisht i zbatuar
A5	Mos respektimi i kritereve gjatë shpërblimit të operatorëve ekonomik	Ministri duhet të rrisë masat e përgjegjësisë ndaj komisioneve për vlerësimin e ofertave, që vlerësimi i ofertave të bëhet me objektivitet dhe të siguroj se me kontratë do të shpërblehen vetëm operatorët meritor dhe të përgjegjshëm.	Gjatë testimit të procedurave të prokurimit nuk kemi identifikuar ndonjë çështje për të theksuar prandaj konsiderojmë se rekomandimi i vitit të kaluar është adresuar.	Rekomandim i zbatuar
B4	Mos funksionaliz im i Sistemit Elektronik i Shpronësimi t	Ministri duhet të rishikoj tërë procesin dhe t'i identifikoj të gjithë faktorët që kanë shkaktuar vonesat në funksionalizimin e këtij sistemi, si dhe të siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme, sistemi do të jetë në përdorim.	Menaxhmenti në planin e veprimit këtë rekomandim e ka planifikuar të zbatoj në vitin 2020. Ekipi i auditimit të vitit 2020 do ta bëjë verifikimin e zbatimit të këtij rekomandimi.	Rekomandim në proces

C2	Pagesat përmes vendimeve gjyqësore	Ministri duhet të siguroj se janë analizuar shkaqet e gjetjeve të prezantuara më lartë. Në bashkëpunim me Avokaturën Shtetërore dhe Gjykatat, duhet të sigurohet që ministria e pranon një kopje të aktvendimeve, në mënyrë që obligimet nga këto aktvendime kryhen me kohë, për t'iu shmangur shpenzimeve shtesë të mundshme si rezultat i procedurave përmbarimore. Po ashtu, për të shmangur shpenzimet tjera shtesë, duhet të diskutohet edhe me Qeverinë dhe Ministrinë e Financave për të siguruar fonde shtesë për kryerjen e obligimeve me kohë për shpronësime.	Menaxhmenti nuk kishte arritur të zbatoj këtë rekomandim, prandaj ministria edhe pse pranon një kopje të aktvendimit nga Avokatura Shtetërore, ka pasur raste kur palët lëndën e kanë dërguar tek përmbarimi dhe si rezultat shpenzimet janë rritur.	Rekomandim i pazbatuar
B5	Regjistrimi në kode jo adekuate të pagesave për shpronësime	Ministri duhet të forcojë kontrollet e brendshme në fushën e pagesave dhe financave, për të siguruar që të gjitha shpenzimet klasifikohen saktë dhe në pajtim me planin kontabël qeveritar.	Gjendja është e njejtë edhe këtë vit.	Rekomandim i pazbatuar
A6	Mangësi në procedimin e pagesave	Ministri duhet të vendos kontrolle të shtuara financiare dhe të siguroj se zyrtarët financiar zbatojnë me përpikëri të gjitha procedurat e shpenzimeve, dhe të gjitha faturat të paguhen brenda afateve të përcaktuara ligjore.	Gjendja për këtë dukuri është e pothuajse të cilën e kemi raportuar në letërmenaxhment.	Rekomandim i pazbatuar
A7	Vonesa në inventarizimin e pasurisë	Ministri duhet të siguroj që komisioni i për inventarizim të hartoj raportin e inventarizimit para hartimit të PFV-ve dhe të siguroj se janë kryer barazimet e gjendjes së inventarizimit të pasurive me regjistrat e organizatës para përgatitjes së PFV-ve të vitit 2019. Raporti duhet të shqyrtohet nga menaxhmenti dhe regjistri i pasurive të azhurnohet varësisht nga rezultatet e inventarizimit.	Menaxhmenti nuk kishte ndërmarrë ndonjë veprim konkret për te adresuar këtë çështje.	Rekomandim i pazbatuar

C3	Vonesë në pagesën e obligimeve	Ministri duhet të siguroj se zyrtarët e financave paraprakisht e konfirmojnë ekzistencën e këtyre detyrimeve, dhe më pas, i procedojnë me kohë të gjitha faturat për pagesë.	Ministria nuk kishte arritur t'i paguaj gjitha obligimet brenda afatit ligjor edhe në 2019.	Rekomandim i pazbatuar
B6	Funksionimi dobët Komitetit Auditimit	Ministri duhet të siguroj që Komitetit i Auditimit do të miratoj statutin e punës të KA dhe do t'i rishikoj në mënyrë të vazhdueshme planet e punës dhe raportet e auditimit të brendshëm dhe do të sugjeroj menaxhmentit marrjen e masave dhe veprimeve në lidhje me rekomandimet e dhëna nga auditimi.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe kishte hartuar statutin për komitetin e auditimit.	Rekomandim i zbatuar
B7	Mungesa e monitorimit të rreziqeve.	Ministri duhet të kërkojë nga personat përgjegjës të ngarkuar me menaxhimin e rrezikut, që të bëhet monitorimi në baza të rregullta kohore, me qëllim që të reduktohet ndikimi i rreziqeve në nivele të pranueshme.	Edhe pse menaxhmenti në planin e veprimit kishte specifikuar se në fund të vitit fiskal do të bëhet azhurnimi i regjistrit të rreziqeve, një regjistër i tillë nuk ishte hartuar.	Rekomandim i pa zbatuar por i mbyllur
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
A1	Të hyrat	Ministri duhet të siguroj se procedurat për shlyerje të borxheve po zbatohen në përpikëri dhe në rastet e mos respektimit, të marrë masa konkrete ndëshkuese ndaj kompanive ujore, siç parashihet me marrëveshjet për shlyerje të borxhit.		
A2	Të hyrat	Ministri duhet të sigurojë monitorimin e procesit të raportimit për shfrytëzimin e ujit nga kompanitë, të sigurojë vlerën financiare të sasisë së ujit të shfrytëzuar dhe të bëjë faturimin në bazë të tarifave të përcaktuara sipas kornizës ligjore.		
B1	Paga dhe Mëditje	Ministri duhet të sigurojë se bëhet monitorimi i rregullt i vijueshmërisë në punë për të gjithë punonjësit e ministrisë dhe në rastet e mos respektimit të orarit të punës të merren masa konkrete siç parashihen me kornizën e aplikueshme ligjore.		

B2	Mallra dhe Shërbime	Ministri duhet të siguroj se angazhimet me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta bëhen duke aplikuar procedurat e thjeshtësuara të rekrutimit të parapara me ligj dhe kohëzgjatja e tyre të jetë brenda afatit 6 mujor.
A3	Mallra dhe Shërbime	Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbikëqyrin në vazhdimësi ecurinë e realizimit të kontratave, në mënyrë që të parandalohen tejkalimet e furnizimeve. Në rastet kur tejkalimi i kontratës arrin shkallën 30% kontrata duhet të ndërpritet menjëherë.
A4	Subvencione dhe transfere	Ministri duhet të siguroj që më së largu 30 ditë pas miratimit të buxhetit vjetor të Republikës së Kosovës, të përgatisin planin vjetor të mbështetjes financiare për OJQ-të dhe t'ia dërgojnë atë zyrës përkatëse për qeverisje të mirë pranë Zyrës së Kryeministrit.
B3	Investimet Kapitale	Ministri duhet të sigurojë që pas pranimit të vendimeve nga Gjykata të siguroj kompletimin e dokumentacionit nga akterët e përfshirë në proces me qëllim që lënda të kompletohet dhe të procesohet për pagesë.
B4	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se për vitet vijuese shpenzimet e shpronësimit të rgjistrohen sipas planit kontabël në mënyrë që ato të klasifikohen saktë.
A5	Pasuritë Kapitale	Ministri duhet të siguroj që regjistri i pasurive të azhurnohet me kohë, me qëllim që vlera e pasurive jo financiare të prezantohet drejtë në RVF dhe të gjitha pasuritë që financohen për organizatat tjera pas plotësimit të kushteve të barten tek përfituesit.
A6	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj që çdo fund vit të formohen komisionet e parapara me rregullore për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive në mënyrë që të shmangen devijimet në raportimin e vlerës së pasurive në Raport Vjetor Financiar.
A7	Llogarite e arkëtueshme	Ministri të sigurojë se po bëhet monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të ujërave të Kosovës dhe në rastet e keqpërdorimit nga kompanitë që operojnë në këtë fushë, të marrë masa konkrete për ndalimin e veprimeve të jashtëligjshme sipas dispozitave të parapara me kornizën ligjore në fuqi.

A8	Obligimet	Ministri të siguroj se mbahen evidenca adekuate lidhur me obligimet e ministrisë në mënyrë që shënimet në RVF të jenë të sakta.
A9	Obligimet financiare te shpronësimi t	Ministri i MMPH-së në bashkëpunim me akterët tjerë të ndërlidhur në këtë proces, të siguroj buxhet të mjaftueshëm për t'i kryer obligimet financiare të shpronësimeve të cilat janë duke u rritur nga viti në vit.
B5	Obligimet e papaguara-	Ministri duhet të siguroj se të gjitha obligimet paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor në mënyrë që të shmangen pagesat direkte nga Thesari.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër konfirmimi



Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2019 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");

- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe

- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Mentor Sylmeta.....

Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit

Datë: 25.06.2020

Prishtinë

Faqe 1 nga 1